Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Nr./Br./No. KP0110971/2024
Data/Datum/Date: 15/11/2024
PRISHTINË-PRIŠTINA PRISTINA

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT
I
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, në Vranidoll

Për: Z. Xhelal Sveçla, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Kopje: Z. Valon Krasniqi, drejtor
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Selman Nimanaj, drejtor
Qendra e Mbajtjes për të Huaj

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

Rr./Ul. Migjeni nr./br.21 • 10000 • Prishtinë/Priština • Kosovë/Kosovo
Tel: +383 (0) 38 223 782, 223 783, 223 784 • Fax: +383 (0) 38 223 790
www.oik-rks.org • info.oik@oik-rks.org

HYRJE

1. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejmë: MKP), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 16 shkurt 2024 dhe më 21 gusht 2024 ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, në Vranidoll (në tekstin e mëtejmë: QMH). QMH-ja funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye të tjera.

2. Kapaciteti i QMH-së është për 75 persona. Gjatë vitit 2023 ishin ndaluar 11 persona në QMH, ku më së shumti kanë qëndruar 5 deri 6 muaj, ndërsa nga janari 2024 e deri në ditën e vizitës (21 gusht) janë mbajtur 21 persona të rritur, asnjë fëmijë i pashoqëruar.

Qëllimi i vizitës

3. Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të të huajve që mbahen në QMH, të cilat parashihen me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Ligjin për Azil, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Keqtrajtimi

4. Gjatë vizitës së realizuar nga MKP-ja, në shkurt 2024, ishte prezent një person me probleme mendore dhe në gusht 2024 ishin prezentë 5 persona të rritur nga Banglladeshi. MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo për sjellje jo të mirë nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH-së. MKP-ja ka kontrolluar dosjet e tyre administrative dhe shëndetësore dhe ka vërejtur se të gjitha rastet vizitohen nga mjeku i emergjencës dhe pastaj vendosen në QMH.

Kujdesi shëndetësor

5. Rregullorja përcakton se pas vendosjes së të huajit në QMH, në afat brenda 24 orësh i huaji dërgohet për ekzaminim mjekësor në QKUK (apo në ndonjë institucion tjetër shëndetësor), nën përcjelljen nga Policia (nga DMH-ja). Ekipi monitorues ka vërejtur se këto kontrolle fillestare të huajve në mbajtje u bëhen nga shërbimet e emergjencës.

6. Të huajve që mbahen në QMH, shërbimet mjekësore u jepen nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, sipas nevojës, dërgohen për shërbime spitalore regjionale dytësore apo edhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ku u ofrohen edhe shërbimet shëndetësore terciare.

7. Ekipi i MKP-së edhe gjatë vizitave të fundit ka vërejtur se në mungesë të infermierit, rasteve u jepen barnat nga zyrtarët e QMH-së. MKP-ja gjithashtu ka vërejtur se raportet shëndetësore, për shkak të mungesës së personelit të kualifikuar, mbahen së bashku me dosjen e përgjithshme të të huajit. Për sa u përket shërbimeve psikologjike, të cilat parashihen me nenin 41 të Rregullores, MKP-ja ka vërejtur se ato ofrohen nga organizata joqeveritare. **MKP-ja inkurajon institucionet kompetente që të angazhojnë së paku një infermier,**

ashtu siç ka rekomanduar Avokati i Popullit në Raportin me Rekomandime gjatë viteve 2019, 2021.[1]

Kushtet materiale

8. MKP-ja konsideron se kushtet e akomodimit në QMH janë në nivel shumë të mirë, përpos një dhome që është jashtë funksionit, për shkak se personat në mbajtje i kanë dëmtuar xhamat. Të gjitha dhomat e tjera ofronin akomodim të mirë, ngrohje, ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe dushe të cilat ishin në gjendje shumë të mirë dhe të pastër. Të huajt në QMH mund të kenë qasje në dushe sa herë që ata duan. Oborri është rregulluar me disa ulëse/stola, kishte fushën sportive të rregulluar.

9. MKP-ja ka vërejtur se korridoret e QMH-së mbulohen nga kamerat e sigurisë, të cilat janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik, si dhe mbrojtje për personelin nga akuzat e rrejshme. Megjithatë gjatë vizitës së fundit në QMH, MKP-ja është njoftuar nga sigurimi se kamerat nuk kanë pamje të qartë, disa edhe nuk funksionojnë fare si dhe ndriçimi mbrapa objektit është shumë i dobët. Sipas informatave të drejtorit, ky rekomandim kur është dhënë viteve të kaluara nga IAP, autoritetet kanë marrë veprime duke i ndërruar diviarët, mirëpo kamerat që marrin pamjet nuk janë ndërruar. **MKP-ja i vërejti këto mangësi dhe konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime konkrete për t'i evituar mangësitë për sa u përket kamerave në përgjithësi.**

10. MKP-ja ka vërejtur edhe një objekt në oborrin e QMH-së, ku sipas informatave, ky objekt është ndërtuar për stafin administrativ të QMH-së. Objekti ishte i gatshëm, kishte hapësirat e veçanta për mjekun, psikologun, sallën e takimeve, mirëpo nuk është funksional vetëm për shkak të mungesës së linjës së internetit dhe nxehësja ishte jashtë funksionit. **MKP-ja inkurajon MPB-në që t'i evitojë këto mangësi dhe objekti të jetë funksional.**

11. **Ushqimi** - Të gjithë të huajve u sigurohen tri shujta ditore. Sipas drejtorit, MPB-ja ka kontraktuar një kompani, e cila furnizon QMH-në me ushqim. Gjatë vizitës së fundit, MKP-ja nuk ka marrë ankesa për ushqimin nga udhëheqësi i QMH-së dhe as nga të huajt e pranishëm.

Regjimi

12. Neni 24, paragrafi 1, i Rregullores përcakton se çdo i huaj i ndaluar në QMH ka të drejtë për ajrosje së paku dy orë në ditë në mjediset e jashtme të kësaj qendre. Për arsye shëndetësore, udhëheqësi i QMH-së mund ta zgjasë kohën e ajrimit.

13. Gjatë vizitës së fundit nga KPT[2]-ja në QMH, KPT-ja ka shprehur shqetësimin lidhur me mungesën e aktiviteteve rekreative për të huajt, ku ata theksuan se në QMH ofrohet mundësia vetëm për shikimin e TV-së dhe luajtja me ping-pong. KPT-ja ka rekomanduar që të huajve t'u jepet mundësia e qasjes së papenguar në sallën e TV-së, t'u sigurohen një sërë aktivitetesh rekreative, përfshirë edhe ato sportive. Sipas KPT-së, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet që u ofrohen atyre.

14. MKP-ja gjatë vizitës së fundit është informuar nga zyrtari i QMH-së se kur kanë qenë disa sirianë më problematikë, ku edhe dy prej tyre janë arratisur, stafi ka qenë më strikt në

[1] https://oik-rks.org/2019/03/27/raport-me-rekomandime-te-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-per-te-huaj-ne-vranidoll/, https://oik-rks.org/2021/04/29/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/

[2] Shih Raportin e CPT për vizitën e fundit në Kosovë, e realizuar në tetor 2020 dhe raporti i publikuar në shtator 2021 https://rm.coe.int/1680a3ea32.

rendin e ditës, me dy orë në ditë shëtitje, si dhe aktivitete sportive brenda asaj kohe, mirëpo pasi janë larguar ata persona të Sirisë, për të tjerët ka pasur liri më të madhe, ku përpos dy orëve të shëtitjes, kanë qasje të papenguar në oborr, në fushën sportive dhe në sallën e TV-së. Gjithashtu është vërejtur mungesë e aktiviteteve rekreative dhe nga ekipi i MKP-së.

15. Sipas informatave të marra nga drejtori i QMH-së, pas aprovimit në Kuvend të plotësim-ndryshimit të Ligjit për të Huajt, i cili ligj është ende në proces, do të ndryshohet edhe Rregullorja e QMH-së duke i përfshirë edhe rekomandimet e KPT-së dhe të Avokatit të Popullit. MKP-ja e Avokatit të Popullit do t'i përcjellë të gjitha veprimet e autoriteteve për sa i përket legjislacionit dhe implementimit të rekomandimeve.

Incidentet në QMH

16. MKP-ja ka verifikuar regjistrat si në vijim: Regjistrin për tentim vetëvrasje; Regjistrin për grevë urie; Regjistrin ku evidentohen personat e izoluar në dhomën e vetmisë; Regjistrin e incidenteve. Gjatë vitit 2023 nuk kishte raste të evidentuara në këta regjistra, përpos një rast i vetëlëndimit, i regjistruar më 2.11.2023, i cili ishte vetëlënduar me pjatë. Është verifikuar dosja dhe është evidentuar që personi i cili është vetëlënduar kishte marrë ndihmë mjekësore. Në mungesë të infermieres, terapia i ishte dhënë nga drejtori.

17. Sipas Rregullores, masat disiplinore që mund t'i shqiptohen të huajit, janë: vërejtja me gojë apo me shkrim; detyrimi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e QMH-së; heqja e së drejtës për aktivitete të lira, për rekreacion, për televizor, për internet; heqja e së drejtës për aktivitete kulturore dhe sportive në kohëzgjatje deri në 5 ditë; dhe izolimi deri në 48 orë.

18. Nga janari deri në gusht 2024, MKP-ja ka evidentuar një incident mes një siriani dhe një të huaji nga Banglladeshi, ku siriani e kishte lënduar peronin tjetër dhe të njëjtit, më 9 maj 2024, i ishte shqiptuar masa e izolimit në kohëzgjatje 48 orësh. Për rastin ishte njoftuar edhe policia. Sipas zyrtarit të Qendrës, personit i ishte lexuar vendimi në gjuhën që ai e ka kuptuar dhe ishte vendosur në qeli të izolimit.

Garancitë procedurale gjatë paraburgimit

19. Ligji për të Huajt u ofron një sërë garancish të rëndësishme ligjore të huajve të privuar nga liria. Sipas Ligjit, i huaji ka të drejtë të parashtrojë padi në gjykatën themelore kundër vendimit për ndalim, brenda afatit prej tridhjetë ditësh pas pranimit të vendimit për ndalim ose zgjatjen e ndalimit. Pala e pakënaqur me vendimin e gjykatës mund të parashtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit.

20. Të huajit i ofrohet këshillimi, përfaqësimi juridik dhe, kur është e nevojshme, ndihma gjyqësore nga Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas. MKP-ja gjatë vizitës së fundit është informuar se pesë të ndaluarit nga Banglladeshi janë në procedurë të azilit, dy prej tyre u është refuzuar kërkesa për azil. Njëri ka bërë padi në Gjykatën Themelore dhe tjetri ka bërë ankesë në Komisionin brenda MPB-së, ku për këto u ka ndihmuar Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas.

21. Sipas Rregullores, i huaji i vendosur në QMH ka të drejtat si në vijim: "*Informimi lidhur me të drejtën e ankimit për ndalimin në Qendër, të drejtën lidhur me ndihmën juridike falas, të drejtën për përkthyesin në gjuhën e tij ose në një gjuhë të cilën ai/ajo e kupton, të drejtën*

për të komunikuar me organet dhe organizatat relevante vendore apo ndërkombëtare, si dhe me organizatat joqeveritare.",[3] të cilat janë në pajtim me standardet e KPT-së.

22. KPT-ja[4] gjatë vizitës së fundit në Kosovë, në raportin e tyre për QMH-në, ka shprehur shqetësimin lidhur me informimin për të drejtat e të huajve, ku sipas tyre, broshura që ishte në dispozicion të të huajve të ndaluar kishte informata rreth Qendrës, mirëpo nuk kishte informata të rëndësishme për njoftimin për të drejtat e tyre, si dhe nuk kishte informata për procedurat e ankimit.

23. MKP-ja gjatë vizitës së fundit ka vërejtur se të huajt në QMH tani informohen për të drejtat e tyre përmes broshurave të shkruara në gjuhë të ndryshme, si: shqipe, angleze, serbe, arabe. Përveç kësaj, ata njoftohen për të drejtat e tyre nga përkthyesi i gjuhës arabe, si dhe nënshkruajnë deklaratën (në cilësi të dokumentit zyrtar), e cila është e shkruar në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht, ku të huajt e ndaluar deklarojnë se janë njoftuar për të drejtën e tyre. Sipas drejtorit të Qendrës, të huajt, përmes broshurave në gjuhë të ndryshme, njoftohen menjëherë për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë ashtu siç e përcakton edhe Rregullorja.

24. MKP-ja gjatë vizitave në QMH shpërndan broshura me informata për mandatin e MKP-së dhe numrat kontaktues të Institucionit të Avokatit të Popullit, për t'u drejtuar për çdo ankesë apo kërkesë. Broshurat janë në gjuhë serbe, angleze, turke dhe arabe. Gjithashtu gjatë vizitës së fundit, ekipi i MKP-së ka kërkuar nga zyrtari i Qendrës që secilit të ndaluar t'ia prezantonte broshurën e MKP-së.

Kontakti me botën e jashtme

25. Rregullorja përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës, në kohëzgjatje prej 5 minutash, duke filluar nga ora 9:00 deri në orën 16:00, çdo ditë pune. Lidhur me këtë, ekipi i MKP-së nuk ka marrë ankesa. Pasi ky është një paraburgim administrativ dhe jo paraburgim klasik, **MKP-ja konsideron se është e rëndësishme të jepen më shumë të drejta për sa u përket kontakteve me botën e jashtme dhe qasje në internet, Skype, por edhe në aktivitetet e tjera jashtë dhomave të tyre.**

Konstatimet

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKP) i Avokatit të Popullit konstaton se në mungesë të personelit të kualifikuar mjekësorë, personeli i Qendrës ua shpërndanë terapinë të huajve në mbajtje, duke u bazuar në raportin e shkruar nga mjeku kompetent e cila është në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Rregulloren nr. 04/*2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt* dhe me standardet ndërkombëtare të përcaktuara për paraburgimin për shkak të imigrimit. Për këtë gjetje, Avokati i Popullit ka rekomanduar në Raportin me Rekomandime gjatë viteve 2019, 2021, 2022,[5] ku ka rekomanduar që "***QMH-ja duhet ta ketë në dispozicion së paku një infermier, e cila do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH"*** dhe i cili është në pritje për implementim.

[3]Neni 11 i Rregullores, Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, në: https://rm.coe.int/16806fbf12.

[4] Po aty. https://rm.coe.int/1680a3ea32.

[5] https://oik-rks.org/2019/03/27/raport-me-rekomandime-te-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-per-te-huaj-ne-vranidoll/, https://oik-rks.org/2021/04/29/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/

- MKP e Avokatit të Popullit konstaton se për shkak të mungesës së personelit të kualifikuar mjekësorë, raportet shëndetësore mbahen së bashku me dosjen e përgjithshme të të huajit e cila e cenon konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore dhe është në kundërshtim me Rregulloren nr. 04/*2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt*, me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-172 *për Mbrojtjen e të Dhënave Personale* si dhe me standardet ndërkombëtare. Për këtë gjetje, Avokati i Popullit ka rekomanduar në Raportin me Rekomandime gjatë viteve 2021, 2022[6] i cili është në pritje për implementim.
- MKP e Avokatit të Popullit ka konstatuar se kamerat të cilat janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik, si dhe mbrojtje për personelin nga akuzat e rrejshme, nuk kanë pamje të qartë, disa edhe nuk funksionojnë fare si dhe ndriçimi mbrapa objektit është shumë i dobët. Për këtë gjetje, Avokati i Popullit ka rekomanduar në Raportin me Rekomandime gjatë vitit 2022[7], i cili është në pritje për implementim.
- MKP e Avokatit të Popullit konstaton se objekti i ndërtuar për stafin administrativ të Qendrës, i cili i plotëson të gjitha kushtet infrastrukturore, por për shkak të mungesës së linjës së internetit dhe mosfunksionimit të nxemjes, ky objekt është jashtë funksionit. (Shih paragrafin 10).
- Duke pasur parasysh se ndalimi për shkak të imigrimit është formë e ndalimit administrativ të personave dhe jo paraburgim klasik, MKP e Avokatit të Popullit konstaton se Rregullorja nr. 04/*2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt* ka kufizime sa i përket kontakteve me botën e jashtme si p.sh qasje në internet, Skype, dhe se ka mungesë të aktiviteteve rekreative sidomos për personat që qëndrojnë gjatë. (shih paragrafin 15 dhe 25).

  Lidhur me gjetjet për komunikim me botën e jashtme, Avokati i Popullit ka rekomanduar në Raport me Rekomandime gjatë vitit 2022[8], që "***të huajve të ndaluar t'u mundësohet komunikimi online me familjet e tyre",*** i cili rekomandim është në pritje për implementim.

26. Bazuar në të gjeturat gjatë vizitës së Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike:

- **Të funksionalizohet objekti i dedikuar për stafin (shih paragrafin 10).**
- **Të shtohen aktivitete rekreative.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar*

[6] https://oik-rks.org/2019/03/27/raport-me-rekomandime-te-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-per-te-huaj-ne-vranidoll/, https://oik-rks.org/2021/04/29/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/

[7] https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huaj-ne-vranidoll/

[8] Po aty.

rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit